

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT

E-bulletin

Nëntor, 2021

SBASHK u takua me Ministrin Sfeçla dhe Ministren Nagavci

Informatë nga dora e parë lidhur me Ligjin e pagave



Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Xhelal Sfeçla me anëtarë të kabinetit të tij dhe Ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci janë takuar me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë deklaruar në fillim të këtij takimi se kanë bërë shumë përpjekje për të nisur takimet e sindikatës me përfaqësues të institucioneve me qëllim që të marrin informacione nga dora e parë lidhur me fatin e Ligjit të pagave dhe se i gjëzohen këtij takimi me...(faqe 4).

Vazhdon të realizohet një aktivitet me vlerë për anëtarësinë

Trajnine sipas vullnetit të kolegeve e kolegëve tanë

Krahas realizimit të agjendës së zgjedhjeve të brendshme dhe angazhimeve të shumta në realizimin e kërkesave të anëtarësisë, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ...(faqe 8)

Interview me mësimdhënësen dhe trajneren Hanife Salihu

Puna në arsim angazhim fisnik dhe mision me vlerë



Hanife Salihu është magjistër në gjuhë...(faqe 3)

Kuvende zgjedhore në gjashtë komuna të Kosovës

Respekt për përkushtimin e arritjet, ide për angazhimet në të ardhmen



Rrethanat e krijuara nga Covid kanë paraqitur vështirësi në realizimin e ...(faqe 6)

Takim me Këshillin e Prindërve të Prishtinës

Thirrje prindërve për angazhime të përbashkëta



Prindërit ishin shprehur vazhdimesh se përkrahin kërkesat legitime ...(faqe 5)

Editorial



Në historinë e popullit shqiptar nëntori dhe marsi janë muaj që në të kaluarën sollën ngjarje të veçanta, që kujtohen me respekt dhe janë momente të lartësimit të kujtimit për figurat emblemë të kombit. Çdo nëntor shumë nga qytetarët e Kosovës nisin rrugëtimin drejt Vlorës për të festuar bashkë ditën e flamurit kombëtar e për të lartësuar kujtimin për figurat e ndritura të asaj kohe. Ata në këto bashkëbiseda me krenari kujtojnë edhe ditëlindjen e Komandantit legjendar Adem Jashari.

Edhe në këtë nëntor shumë qytetarë të Kosovës nisen rrugëtimin drejt Shqipërisë për të parë edhe një herë, nga afër Shtëpinë e flamurit dhe pavarësisë. Shiu i rrëmbyeshëm nuk ua ndali këtë rrugëtim. Ata bënë edhe foto të shumta për t'i ruajtur si kujtim për 28 nëntorin 2021. Ata kanë parë nga afër edhe punimet që po bëhen të kjo pjesë e historisë me qëllim që 110 vjetori i kësaj ngjarje të madhe të festohet në mënyrën më madhështore.

Nëntori po ik. Njerëzit nga atmosfera e festës i kthehen halleve e sfidave të shumta dhe vazhdon t'i mbaj shpresë për ditë më të mira. Ata do të jenë bashkë edhe në mars për të lartësuar kujtimin për pishtarët e dijes dhe për Epopenë e lavdishme të UÇK-së.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të viziton ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos heziton të na jepni sygjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektonike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit International (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383 (0) 38/ 226 940



Intervista

Intervistë me mësimdhënësen dhe trajneren Hanife Salihu

Puna në arsim angazhim fisnik dhe mision me vlerë



Hanife Salihu është magjistër në gjuhë dhe letërsi shqipe. Ajo është shembull i mirë i angazhimit e përkushtimit në misionin e shenjtë për edukimin dhe arsimimin e brezave. Është edhe veprimtare e dalluar sindikale dhe jep kontribut me vlerë edhe si trajnere në trajnimet e licencuara të SBASHK-ut.

Arsimimi sot :

Kush është Hanife Salihu ?

Hanifja:

Jam magjistër i gjuhës dhe letërsisë shqipe. Jam mësimdhënëse në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj. Kohë pas kohe merrem edhe me shkrime duke publikuar opinione për gjendjen aktuale në vendin tonë.

Arsimimi sot :

Si e vlerësoni profesionin e mësimdhënies?

Hanifja:

Profesioni i mësimdhënies është profesion fisnik dhe mision me vlerë sepse mësuesi nis rrugëtimin e çdo fëmije drejt njohurive të reja dhe e përgatit atë për t'u përballur suksesshëm me sfidat dhe për të qenë në të ardhmen në shërbim të popullit dhe atdheut të tij. Mësimdhënësi me tërë mundësitë e tij intelektuale e profesionale angazhohet për një arsimim e edukim sa më të mirë të fëmijëve sepse ata janë e ardhmja e këtij vendi.

Arsimimi sot :

Çfarë mendon për trajnimet e licencuara të SBASHK-ut, të cilat u ofrohen mësimdhënësve të Kosovës ?

Hanifja:

Trajinimet që ofron SBASHK-u janë të licencuara nga Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve

në kuadër të MASHTI-t. Janë këto trajnime të qëlluara që i mundësojnë pjesëmarrësve marrjen e njohurive të reja për t'i vënë ato pastaj në shërbim të ngritjes së vazdueshme të cilësisë e po ashtu krijojnë mundësinë që vijuesit të pajisen me certifikata dhe të kenë orët e duhura e të kërkua për licencën e punës dhe për të krijuar bazë të mirë të përgatitjes për procesin e gradimeve.

Arsimimi sot :

Çka do të veçonit nga angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut?

Hanifja:

Angazhimet e SBASHK-ut janë të shumta dhe që të gjitha janë bërë bazuar në kërkkesat e punëtorëve të arsimit. Janë shënuar edhe arritje të shumta falë përkushtimit të nivelit qendror, por edhe të kryetarëve të nivelit komunal e të universiteteve, por edhe të veprimtarëve të shumtë të sindikatës kudo në Kosovë. Këto angazhime e arritje, besimi i ndërsjellë dhe përballja me sfidat ka bërë që SBASHK-u të gëzoj respekt të lartë kudo në Kosovë.

Arsimimi sot :

Me cilat çështje duhet të merret aktualisht SBASHK-u

Hanifja:

SBASHK duhet të vazhdojë me angazhimet lidhur me ligjin e pagave dhe me angazhimet tjera në shërbim të anëtarësise.

Arsimimi sot :

A keni ndonjë këshillë për kolegët e koleget tuaja kudo në Kosovë?

Hanifja :

Të angazhohemi bashkërisht dhe ta ruajmë unitetin e shkëlqyer në SBASHK. Të vazhdojmë me punë e përkushtim më realizimin e misionit tonë për edukimin e arsimimin e brezave dhe krejt në fund dua t'ua uroj festat e fund vitit me dëshirën për shëndet të mirë dhe suksese të shumta në punë e jetë.



Gjatë muajit

SBASHK u takua me Ministrin Sfeçla dhe Ministren Nagavci

Informatë nga dora e parë lidhur me Ligjin e pagave

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Xhelal Sfeçla me anëtarë të kabinetit të tij dhe Ministren e Arsimit, Arbërie Nagavci janë takuar me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë deklaruar në fillim të këtij takimi se kanë bërë shumë përpjekje për të nisur takimet e sindikatës me përfaqësues të institucioneve me qëllim që të marrin informacione nga dora e parë lidhur me fatin e Ligjit të pagave dhe se i gjëzohen këtij takimi me Ministrin Sfeçla, Ministria e të cilit edhe është sponzorizuese e Ligjit të pagave. Ata kanë përcjell gjithë shqetësimet e anëtarësisë duke kujtuar se në mungesë të dialogut për një kohe të gjatë kërkesat ishin që të fillohet me veprime sindikale. Ata kanë shtuar se me arsyen kanë pritur që në kuadër të rrjedhës së aktivitetit përgatitjen e versionit të Ligjit pas heqjes së gabimeve që ka përmendur Kushtetuesja, do të bëhej angazhim i përbashkët në përmirësimin e koeficientit përmësuesit dhe për qartësimin e pozitave dhe koeficienteve për një pjesë të të punësuarve në

administratën e Universiteteve. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë kërkuar nga Ministri Sfeçla e Ministrja Nagavci që të angazhohen me gjithë mundësitë e tyre që në Ligjin e buxhetit të caktohen mjete buxhetore që do ta mundësonin implementimin e Ligjit të pagave.

Ministri Sfeçla u ka deklaruar përfaqësuesve të SBASHK-ut se është duke u punuar në Ligjin e pagave dhe se është menduar se faza fillestare do të kryhej më herët, por është parë se duhet pasur kujdes të shtuar në mënyrë që të mos bëhen prapë lëshime, të cilat do të ndikonin që edhe pas votimit të Parlament, Kushtetuesja të gjente lëshime dhe ta kthente prapë ligjin, gjendje kjo që do të shtonte pakënaqësitë të palët. Ai është shprehur se me të përgatitur të versionit të parë, në kohën më të shkurtër të mundshme, para se të dërgohet Ligji në Qeveri, do të hapet debati dhe do të jenë të ftuara edhe sindikatat që të jalin mendimet dhe kontributin e tyre. Ministrja Nagavci duke u kyçur në këtë bashkëbisedë ka theksuar se e ka parasysh çështjen e koeficientit përmësuesit, porse kishin mbetur keq edhe pedagogët, psikologët, sekretarët dhe bibliotekistët.



Duke e vlerësuar si përbajtjesor këtë takim SBASHK do ta mbaj së shpejtë një takim konsultativ nga larg me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve për t'i informuar përrnjedhën e këtij takimi dhe për të vendosur çfarë tutje.

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Takim me Këshillin e Prindërve të Prishtinës

Thirrje prindërve për angazhime të përbashkëta

Prindërit ishin shprehur vazhdimesht se përkrahin kërkesat legjitime të punëtorëve të arsimit, por kanë latur SBASHK-un që të mos shkojë në greva, po të kërkoj zgjidhje përmes formave të tjera të veprimit. Duke u nisur nga kjo SBASHK-u reagimin e vet për mungesë të dialogut lidhur me ligjin e pagave do ta shpreh me një grevë me numër të kufizuar pjesëmarrësish duke kërkuar që edhe Këshillat e prindërve të jenë pjesëmarrës përmes përfaqësuesve të tyre.



Në kuadër të këtyre përgatitjeve SBASHK-u ka nisur takimet konsultative me përfaqësues të Këshillave të prindërve duke filluar me Prishtinën. Në selinë e SBASHK-ut kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së

Arsimit Parauniversitar të Prishtinës, Ahmet Pllana kanë pritur kryetarin e Këshillit të prindërve Jeton Demi dhe anëtarët e kryesisë së Këshillit të prindërve të Prishtinës Nexhmi Hoxha dhe Besim Cakolli.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë thënë se SBASHK po bën gjithë angazhimet e mundshme që çështja e Ligjit të pagave të zgjidhet drejt përmes dialogut dhe takimet të sindikatave me përfaqësues të Qeverisë në mënyrë që të mos shkohet në grevë dhe prandaj ka ftuar përfaqësuesit e Këshillave të prindërve që të jenë bashkë me SBASHK-un në këto angazhime me shpresë se mesazhi i përbashkët do të kuptohet drejt nga Qeveria dhe do të nis zgjidhja e drejtë për ligjin e pagave. Nëse edhe këto angazhime nuk janin rezultatin e pritur, atëherë do të ndodhin grevat në tërë sistemi arsimor.

Kryetari i Këshillit të Prindërve për Prishtinën Jeton Demi bashkë Nexhmi Hoxhën e Besim Cakollin janë shprehur se përkrahin kërkesat legjitime të SBASHK-ut dhe shprehin respekt për përpjekjet që çështjet të zgjidhen me dialog. Po ashtu kanë lavdëruar angazhimin për gjithë këtë angazhim në mënyrë që të mos vije deri të grevat që paralizojnë tërë sistemin arsimor. Ata janë shprehur se do të debatojnë me kryesinë e Këshillit të prindërve të Prishtinës për të qenë bashkë me 4 dhjetor në protestë me shpresën se Qeveria do të reflektojë dhe do të arrihet marrëveshje pa pasur nevojë për veprime të tjera.

Takime të SBASHK-ut edhe me shefat e Grupeve Parlamentare

Të angazhohemi bashkë për të gjetur zgjidhje të pranueshme



U ka dërguar ftesa për takime gjithë shefave të Grupeve Parlamentare për t'u angazhuar bashkërisht në gjetjen e zgjidhjes së pranueshme lidhur me kërkesën legjitime për Ligjin e pagave. Ky aktivitet ka filluar të realizohet dhe pas pjesëmarrjes në një tryezë me sindikatat organizuar nga shefi i grupit parlamentar të AAK-së, z.Besnik Tahiri, kërkesës së SBASHK i është përgjigjur shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Mimoza Kusari Lila. Takimi është zhvilluar në ambientet e

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Parlamentit të Kosovës dhe SBASHK-u është përfaqësuar nga kryetari Rahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë informuar znj. Kusari Lila dhe kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim z.Ardian Gola lidhur me situatën në arsim duke u ndalur të kritika për mungesën e gatishmërisë së institucioneve për dialog lidhur me Ligjin e pagave e duke kërkuar nga ta që të kontribuojnë që të niset me dialogun dhe që Qeveria bashkë me sindikatat të gjejnë zgjidhje lidhur me Ligjin e pagave. Ata kanë kërkuar nga shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Mimoza Kusari Lila që të angazhohet bashkë me gjithë deputetët e këtij subjekti politik që në Ligjin për buxhet të planifikohen mjete që mundësojnë implementimin e ligjit të pagave.

Kuvende zgjedhore në gjashtë komuna të Kosovës

Respekt për përkushtimin e arritjet, ide për angazhimet në të ardhmen

Rezhanat e krijuara nga Covid kanë paraqitur vështirësi në realizimin e agjendës së takimeve zgjedhore nëpër komunat e Kosovës dhe në Universitet, por falë angazhimit e përkushtimit të stafit qendror dhe kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të Universiteteve ky aktivitet është realizuar me sukses duke krijuar kushtet që se shpejti të mbahen Kuvendet zgjedhore të arsimt fillor, atij të mesëm dhe pastaj edhe të Universiteteve.

Në kuadër të realizimit të kësaj agjende në muajin nëntor janë mbajtur Kuvende zgjedhore të sindikatës së Arsimit parauniversitar në Rahovec, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Drenas dhe Istog për të cilat kemi botuar raporte të zgjeruara në ueb faqen e SBASHK-ut. Në këtë numër të gazetës sonë "Arimimi sot" do t'ju rikujtojmë momentet kryesore nga këto Kuvende zgjedhore.

Në sallën e takimeve të Asamblesë komunale të Rahovecit është mbajtur Kuvendi zgjedhor i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë. Pjesë e punimeve të këtij kuvendi kanë qenë edhe kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe zyrtarin ligjor Blendor Shatri. Pasi është

Shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Kusari Lila është deklaruar se do të bëj gjithë angazhimet me qëllim që të ketë dialog dhe informim të ndërsjellë me SBASHK-un lidhur me angazhimet për Ligjin e pagave, por edhe për çështje të tjera që kanë të bëjnë me kërkeshat e anëtarësisë. Edhe kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim z.Gola është shprehur se ka gatishmëri të takohet me përfaqësues të SBASHK-ut me qëllim që të bashkëbisedojnë e angazhohen bashkërisht në shërbim të arsimit dhe ngritjes së vazhdueshme të cilësisë. SBASHK do të vazhdojë takimet edhe me shefat e Grupeve tjera Parlamentare duke kërkuar nga ata që në takimet e Parlamentit të angazhohen që në Ligjin për buxhet të jenë saktësuar mjetet buxhetore për Ligjin e pagave.

aprovar reporti i punës dhe ai financiar është nisur me procesin e zgjedhjeve.



Me të kryer të procesit të votimeve Komisioni ka shpallur rezultatet nga të cilat shihet se kryetari Veli Morina mori besimin edhe për një mandat, ndërsa nënkyetare u zgjodh Arlinda Kastrati. Me votën e lirë e të fshehtë janë zgjedhur edhe anëtarët e Kryesisë, Komisioni mbikëqyrës, delegatët e kësaj komune për Kongresin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut.

Në Prizren takimi është mbajtur në sallën e takimeve të Hotelit "Theranda". Kryetari Reshit Kushaj dhe veprimtarët tjerë të sindikatës sonë nga kjo komunë kishin bërë gjithë angazhimet e duhura që Kuvendi të ketë rrjedhë të mbarë. Në fillim të këtij takimi



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

kryetari Reshit Kushaj ka përshëndetur anëtarët e këtij Kuvendi pastaj ka falënderuar për pjesëmarrje kryetarin SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Prishtinën, Ahmet Pllana. Me votën e lirë e të fshehtë kryetar është rizgjedhur Reshit Kushaj dhe kjo është dëshmi, si thoshin shumë nga pjesëmarrësit, e besimit dhe respektit për punën, përkushtimin dhe arritjet sindikale në këtë komunë e për të cilat respekt meritor ka Kushaj. Me votën e fshehtë është zgjedhur edhe nënkyetarja Rebiha Imami, Kryesia, Komisioni mbikëqyrës, delegatët për Kongresin e SBASHK-ut dhe anëtarët e Këshillit Drejtues.



Atmosferë angazhimi, uniteti e përkushtimi ishte edhe në Kuvendin zgjedhor në Pejë. Pas leximit dhe aprovimit të raportit të punës dhe atij financiar u kalua në procesin zgjedhor dhe me votën e fshehtë anëtarët e pranishëm i dhanë besimin edhe për një mandat Isuf Lajçit, ndërsa po me votën e lirë e të fshehtë nënkyetare u zgjodh Shpresa Nushi.



Atmosferë uniteti e përkushtimi ishte edhe në takimin zgjedhor në Mitrovicë. Kryetari Isa Ismajli ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar, të cilët janë aprovuar nga të pranishmit. Edhe në këtë Kuvend procesi zgjedhor është zhvilluar në garën mes dy e më shumë kandidatëve. Anëtarët e këtij Kuvendi kanë lavdëruar angazhimet e kryetarit Ismajli dhe këtë e kanë dëshmuar me votën e lirë e të fshehtë duke e rizgjedhur edhe për një mandat. Nënkyetare është zgjedhur, po ashtu me votën e lirë e të fshehtë Arta Haxhimehmeti.



Edhe në Drenas është mbajtur Kuvendi zgjedhor i sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë. Pas prezantimit të raportit të punës dhe atij financiar dhe aprovimit të tyre nga pjesëmarrësit është zhvilluar edhe pjesa e dytë e Kuvendit duke u bërë kandidimi e pastaj edhe votimi përmes votës së fshehtë për kryetarin, nënkyetaren dhe organet tjera të këtij Kuvendi. Duke shprehur respekt për punën dhe përkushtimin në vitet e kaluara Kuvendi me votë të fshehtë ka rizgjedhur për kryetar Ilaz Dervishin, kurse nënkyetare është zgjedhur Zejnepe Gjoshi Gruda.





Është mbajtur në muajin nëntor edhe Kuvendi i sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Istogut. Kryetari Muzli Blakaj ka prezantuar raportin e punës dhe atë financiar që janë aprovuar. Edhe anëtarët e këtij Kuvendi kanë bërë propozime për kryetar, nënkyetare dhe organet tjera të këtij Kuvendi. Duke shprehur respekt për angazhimet e tij ky Kuvend me votën e lirë ka rizgjedhur Muzli Blakajn për kryetar, ndërsa nënkyetare është zgjedhur Vlora Vuthaj.



Vlen të theksohet se në të gjitha këto takime zgjedhore kanë marrë pjesë kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm e në ndonjë prej tyre edhe nënkyetarja Vjollca Shala e zyrtari ligjor Blender Shatri duke dhënë kontribut të çmuar për rrjedhën e mbarë të këtyre takimeve dhe për respektimin në tërësi të Statutit të SBASHK-ut. Edhe në këto Kuvende pjesëmarrësit duke vlerësuar lart angazhimet e kryetarit Jasharaj dhe stafit qendror kanë kandiduar kryetarin Jasharaj edhe për një mandat që të jetë kryetar i SBASHK-ut.

Vazhdon të realizohet një aktivitet me vlerë për anëtarësinë

Trajnime sipas vullnetit të kolegeve e kolegëve tanë


Krahas realizimit të agjendës së zgjedhjeve të brendshme dhe angazhimeve të shumta në realizimin e kërkesave të anëtarësissë, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me një pjesë të stafit qendror po vazhdojnë me gjithë përkushtimin për të realizuar vullnetin e shumë punëtorëve të arsimit nga komunat e Kosovës për organizimin e trajnimeve të licencuara të SBASHK-ut.

Kështu ishte edhe të dielën e 7 nëntorit kur falë këtij përkushtimi filluan mbarë trajnimet “Udhëheqje dhe planifikimi strategjik ne Arsimin Parauniversitar” me trajnerin Hysen Sogojeva, trajnimi “Edukimi dhe menaxhimi mjedisor ne Arsimin Parauniversitar”, me trajnerin Agim Hasani, pastaj trajnimi “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive te dialogut social” me trajnerin Safet Beqiri.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Po të dielën e 7 nëntorit ka filluar me sukses edhe trajnimi "Roli i aktivitetave kreative në mësimdhënie dhe zbatimi i tyre në shkollat filllore" në dy grupe të ndara me trajnerin Ahiret Mehmeti dhe trajneren Zahide Hamiti Krasniqi, trajnimi "Mësimdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe për arsimin fillor dhe të mesëm" me trajneren Pranvera Haziri, trajnimi "Edukimi medial dhe roli i tij në zhvillimin shoqëror dhe demokratik" me trajneren Blerta Dibrani, trajnimi me kolegët e komunitetit turk " Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në Arsimin Parauniversitar" me trajneren Esyngyl Dinovci dhe trajnimi "Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës" për kolegët e ndarë në tri grupe me trajnerët Nora Ajeti, Eliza Dibrani dhe Labearta Selimi.



Vlen të theksohet se të gjithë këto trajnimeve kanë nisur me kohë dhe kanë pasur rrjedhë të mbarë. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri është kyçur dhe ka bashkëbiseduar me pjesëmarrësit e të gjitha këtyre trajnimeve duke përgëzuar trajnerët për angazhimin dhe përkushtimin dhe pjesëmarrësit për vullnetin, që krahas angazhimit në procesin mësimor, të jenë pjesë edhe të këtij aktiviteti, i cili është ndihmesë e madhe për arritjen e njohurive të reja në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë. Për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti është përkujdesur edhe zyrtarja për trajnime në SBASHK Albina Ahmeti. Ky aktivitet do të vazhdojë për të realizuar objektivat sipas marrëveshjes me stafin qendror dhe trajnerët e pjesëmarrësit duke pasur kujdes që të mos pengohet as edhe për një çast procesi mësimor.

Takim i përfaqësuesve të SBASHK-ut me Ministren Nagavci

Kërkesë Ministres për angazhim në shërbim të dialogut

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri janë takuar me Ministren e MASHTI-t, Arbërie Nagavci duke e informuar atë me situatën aktuale në arsim dhe me kërkesën legitime të anëtarësisë lidhur me Ligjin e pagave duke ritheksuar se presin takime dhe dialog me Ministrin Hekuran Murati dhe me Kryeministrin Kurti. Ata kanë kërkuar që Ministrja Nagavci të angazhohet për të nisur dialogu mes SBASHK-ut dhe Qeverisë lidhur me këtë çështje me rëndësi ngase janë shtuar kërkesat e anëtarësisë për veprime sindikale.

Ministrja Nagavci është shprehur se do të bëj gjithë angazhimet për të ndihmuar që të ketë takime të

SBASHK-ut dhe përfaqësuesve të institacioneve në mënyrë që me dialog të gjendet zgjidhje e pranueshme për këtë çështje të ngritur.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Respekt meritor ndaj anëtarësisë së SBASHK-ut

Marrëveshje me “Agaj-Medical” për zbritje 30 % të shërbimeve



Duke shprehur respekt meritor për punën e madhe të punëtorëve arsimor nëpër vite e dekada për arsimimin e edukimin e brezave, drejtori i Ordinancës mjekësore “AGAJ-MEDICAL”, dr. Atdhe Agaj me bashkëpunëtorët kanë vizituar SBASHK-un dhe fillimisht kanë bashkëbiseduar me kryetarin Rrahman Jasharaj dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Drejtori i kësaj Ordinance ka shprehur respekt të lartë për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë duke shtuar se ai,

bashkëpunëtorët e tij dhe i gjithë stafi i Ordinancës ruajnë kujtimet për mësuesit e tyre dhe respektin meritor për të gjithë të punësuarit në arsim, që kanë dhënë e po jepin kontribut të lartë në rrugëtimin drejt diturive të reja për nxënësit e tyre.

Kryetari i SBASHK-ut Jasharaj dhe koordinatori Ymeri kanë falënderuar dr. Atdheun dhe gjithë stafin e kësaj Ordinace për vullnetin e shprehur që të lidhin marrëveshje që siguron zbritje çmimesh prej 30 % për Vizita mjekësore, Vizita mjekësore shtëpiake, kujdesi ndaj plagëve, pastrimi dhe lidhja e tyre me fashë, dhënia e injeksioneve, dhënia e infuzioneve, inhalime, vendosja dhe ndërrimi i kateterit urinar, marrja e gjakut dhe urinës për analiza, EKG me interpretim, klizma pastruese, vendosja e sondës nasogastrike, trajnimi i dekubitit, transporti mjekësor për të sëmurit brenda dhe jashtë Kosovës, Asistenza në shtëpi dhe spitale 12/24 orë.

Do theksuar se kjo zbritje në gjithë këto shërbime, përvèç për anëtarin e SBASHK-ut vlejnë edhe bashkëshorten a bashkëshortin, fëmijët dhe prindërit e anëtarit të SBASHK-ut.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture